



# AWESK

SHOQATA E GRAVE NË SEKTORIN E ENERGJISË NË KOSOVË  
ASSOCIATION OF WOMEN IN THE ENERGY SECTOR OF KOSOVO

# Për fuqizimin e grave dhe vajzave në sektorin e energjisë

MENTORIM



RRJETËZIM



AFTËSIM



KARRIERË



# Powerful

“ *Ne s'mund të bëjmë dot gjëra të mëdha,  
vetëm gjëra të vogla me dashuri të madhe.* ”

- Nënë Tereza



**Arijeta Pajaziti Qerimi\***  
Drejtoresh Ekzekutive

## Shoqatë që trason rrugën e grave në energji

Përderisa sektori i energjisë në tërë botën po orientohet drejtë energjisë së pastër dhe po avancohet teknologjikisht, një fushë ende ka mbetur kritike në të cilën duhet punuar më shumë - diversiteti dhe barazia gjinore. Sektori i energjisë, sidomos në Kosovë, vazhdon të mbetet një industri e dominuar nga meshkujt. Gratë bëjnë pjesë me vetëm rreth 10% të fuqisë punëtore, edhe pse në programet akademike regjistrohen në numër të barabartë.

Mbetet pyetja: si ta trasojmë një rrugë që të kultivojmë talentin e lidershit të grave brenda sektorit të energjisë?

Shoqata e Grave në Sektorin e Energjisë së Kosovës (AWESK) u lansua në qershor të vitit 2017 që të merremi me këtë çështje. Në AWESK, ne punojmë me gratë dhe për gratë. Shoqata jonë synon krijimin e qasjes dhe mundësive të reja për përparimin dhe fuqizimin e pozitës së grave në sektorin e energjisë.

Kemi identifikuar një numër të objektivave ambicioze që synojmë t'i arrijmë. Ne duam të përmirësojmë mundësitë e karrierës për gratë në sektor përmes trajnimit dhe rrjetëzimit; të rrisim mirëqenien dhe cilësinë e jetës duke qenë më të vetëdijshme për efikasitetin e energjisë, kursimin e energjisë dhe mbrojtjen e mjedisit; dhe që gratë dhe vajzat të kenë

mundësi më të mira për punësim duke tejkaluar hendekun midis arsimimit dhe punësimit në sektorin e energjisë.

Qasja që kemi përqafuar deri më tani është dypalëshe. AWESK-u ka identifikuar dhe po punon për të forcuar pozitën e anëtarëve të veta, të cilat janë gra në sektorin e energjisë. Ato po përkrahen me zhvillimin e shkathtësive, në rrjetëzim, zhvillim të karrierës ndërsa synojmë të ju ofrohen trajnime për mentorim profesional.

Ndërkohë, shoqata iu është drejtuar vajzave në të gjithë vendin përmes sesioneve informuese për të prezantuar sektorin e energjisë si një mundësi karriere. Në të njëjtën kohë, AWESK-u po punon të iu mundësojë institucioneve të identifikojnë veprime konkrete dhe realiste që do t'i fuqizojnë gratë në energji bazuar në vlera dhe zhvillim profesional. Që nga themelimi i saj, shoqata ka zbatuar aktivitete në partneritet me institucionet vendore, komunitetin e donatorëve dhe sektorin e arsimit.

AWESK-u po punon me përkushtim për të zhvilluar ndërhyrjet e ardhshme që kontribuojnë në përmbushjen e misionit të vet, angazhim që përkthehen në krijimin e një sektori gjithëpërfshirës të energjisë.

---

\* Karriera e saj profesionale si inxhinierë e elektroteknikës plotësohet nga arritjet akademike me titullin Msc nga Universiteti i Prishtinës. Ajo është pjesë e sektorit të energjisë për më shumë se 20 vjet. Sot punon si SCADA/EMS specialiste në Sistemin e Transmisionit të Kosovës dhe Operatorin e Tregut (KOSTT) dhe kontribuon në avancimin e agjendës kombëtare për përfshirjen e grave në energji.

## PËR NE

Shoqata e Grave në Sektorin e Energjisë në Kosovë (AWESK) është krijuar si rezultat i rrjetit të mentorimit “mCircle” të krijuar në vitin 2016 për gratë në institucionet e sektorit të energjisë në Kosovë. AWESK u lansua publikisht në qershor të vitit 2017 me mbështetjen e projektit të USAID-it “REPOWER-KOSOVO” dhe është organizata e parë dhe e vetme e shoqërisë civile në Kosovë që fokusohet në çështjen gjinore në sektorin e energjisë.

Deri më tani, AWESK ka mbi 140 anëtare profesioniste të trajnuara dhe të arsimuara nga një gamë e gjerë profilesh, duke përfshirë: gra inxhinierë, teknologji informacioni, eksperte ligjore, personel i burimeve njerëzore, marketing dhe marrëdhënie me publikun dhe në fushën akademike të inxhinierisë dhe shkencave shoqërore.

Së fundmi, AWESK-u është përkrahur nga projekti i financuar nga USAID-i “Sigurimi i Furnizimit me Energji në Kosovë (KESS)” në zhvillim të kapaciteteve, komunikim publik, dhe rrjetëzim. Shoqata ka pranuar gjithashtu përkrahje nga Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit si dhe Shoqata Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar (GIZ).

Materialet e përdorura në këtë broshurë janë pronë e AWESK.

Fotografite: Arben Llapashtica

Korrik, 2020

## MISIONI

Misioni i AWESK-ut është të fuqizojë gratë në sektorin e energjisë në Kosovë nëpërmjet zhvillimit profesional të karrierës, rrjetëzimit, pjesëmarrjes në vendimmarrje dhe kontributit në zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik të Kosovës.

## VIZIONI

Vizioni i AWESK-ut është të përgjigjet drejtpërdrejtë në sfidat me të cilat ballafaqohen gratë në sektor, duke përfshirë nën-përfaqësimin në mjediset profesionale dhe akademike dhe mungesën e mbështetjes institucionale, duke shërbyer si një platformë për të promovuar hyrjen e grave në sektorin e energjisë dhe zhvillimin e tyre profesional.

## ANËTARËSIA

AWESK-u ka mbi 140 anëtare profesioniste, por synon që këtë numër ta rrisë paralelisht me aktivitetet e veta. Rritja e numrit të anëtarëve do të bëhet duke inkuadruar më shumë profesioniste që janë aktive në sektorin e energjisë sikurse edhe të nxisë studentet të bashkohen për të përfituar nga mentorimi dhe zhvillimi profesional.

Të gjitha anëtarët e AWESK-ut kanë një përvojë profesionale dhe vijnë nga një gamë e gjerë profilesh, përfshirë:

**Inxhinieri**

**Teknologji informacioni**

**Eksperte ligjore**

**Burime njerëzore**

**Marketing dhe marrëdhënie me publikun**

**Fusha akademike e inxhinierisë dhe shkencave shoqërore**

Krahas përvojës, anëtarët janë të trajnuara nga institucionet dhe ekspertët më kompetentë në vend për të jetësuar misionin e shoqatës. Ato janë të afta për të përgatitur dhe për të zbatuar trajnime, të angazhohen në avokim, si dhe të zbatojnë projekte. Anëtarësia e shoqatës ka gjithashtu lidhje të forta me institucionet e energjisë si dhe marrëdhënie të shëndosha me organizatat e shoqërisë civile.

## ORIENTIMI STRATEGJIK

Qëllimi i AWESK-ut është të avancojë diversitetin gjinor përmes mentorimit, rrjetëzimit, zhvillimit të aftësive dhe vetë-menaxhimit të karrierës. Shoqata synon të ndihmojë institucionet të identifikojnë veprime konkrete dhe të zbatueshme që do të fuqizojnë gratë në industrinë e energjisë për zhvillim profesional.

## OBJEKTIVAT

### Objektivi 1

Rritja e pjesëmarrjes në trajnime dhe rrjetizim për të kontribuar në avancimin në karrierë dhe mundësitë e vendimmarrjes për gratë në sektorin e energjisë.

### Objektivi 2

Rritja e vetëdijës mbi eficiencën e energjisë dhe masat e mbrojtjes së mjedisit për të kontribuar në mundësi për cilësi më të lartë të jetës dhe mirëqenies, veçanërisht për vajzat dhe gratë.

### Objektivi 3

Rritja e bashkëpunimit midis sektorëve të energjisë dhe arsimit, si një mjet për të rritur qasjen në mundësitë e punësimit dhe njohjen e konsideratave gjinore në fushën e energjisë.



# Gruaja kosovare në energji

Shoqata krenohet me anëtarët profesioniste që ka në mesin e vet. Secila prej tyre është një tregim suksesi me kontributin e dhënë në formësimin e institucioneve kyçe të energjisë në vendin tonë.

Ne kemi zgjedhur disa prej anëtarëve të AWESK-ut për t'i prezantuar si profile të grave me karrierë në sektorin e energjisë në Kosovë.





PROFILET

# Arta Qorolli Isufi

*Inxhinier e sistemeve  
elektroenergjetike*

-

Zyra e Rregullatorit për Energji – ZRRE



Sektori i energjisë ka shumë punë të larmishme, prandaj edhe profesioni është gjithmonë tërheqës. Gratë dhe burrat kanë mundësi të barabarta, prandaj nuk mendoj se burrat janë më të avancuar ose kanë më shumë përparësi. Kohë më parë, në shoqërinë tonë, stereotipi i inxhinierit ka qenë puna e rëndë me çekiç në dorë ose të punosh pranë një makinerie në termocentral.

Edhe nëse puna e inxhinierit lidhet me terrenin, nuk është domosdo një punë e vështirë. Mirëpo, inxhinieria mund të jetë edhe një punë në zyrë. Nëse ti e do, e bën dhe ia arrin. ”







## PROFILET

# Teuta Buçinca

*Inxiniere mbikqyrëse e projekteve*

–

**Kompania Kosovare për  
Distribim me Energji elektrike – KEDS**

“

Këtë profesion kam filluar ta ushroj para 40 vjetëve dhe kam qenë vazhdimisht në terren.

Puna më jep kënaqësi, më bën krenare në atë që bëjë edhe pse i ka sfidat e veta. Është një punë kreative ngaqë e fillon një projekt nga zero, e zhvillon atë dhe në fund arrin të krijosh diçka të re. Rezultati i një pune të jep kënaqësi të madhe sidomos kur ajo që kemi krijuar i shërben direkt shoqërisë në përmirësimin e jetës së tyre. Kohë më parë, ndoshta, puna që bëjmë nuk ka qenë nevojë aq e madhe, por në ditët e sotme energjia është përditshmëri dhe energjia është e domosdoshme. ”

## PROFILET

# Donijeta Sogojeva

*Inxhinierë e makinerisë*

–


**Korporata Energjetike e Kosovës – KEK**

“

Fillimi i punës në termocentral ka qenë sfidues por e kam menaxhuar mirë. Pas përfundimit të orëve në qendrën e trajnimeve të KEK-ut, kolegët më kanë pyetur përse nuk kam zgjedhur një profesion tjetër më të lehtë, si për shembull të bëhem mësuese, pasi që këtu në termocentral puna është e rëndë.

Të gjitha këto më kanë bërë më të fortë në realizimin e detyrave që më janë dhënë.

Ka ndodhur që gjatë intervenimeve në terren kam qëndruar disa orë në shi, borë e në temperatura të larta bashkë me kolegët burra dhe ia kam dëshmuar vetes dhe të tjerëve që jemi të barabartë. Që nga ato momente të gjithë kolegët kanë filluar të më respektojnë dhe të më shohin si pjesë të ekipit. ”





## PROFILET

# Makfirete Bina

*Inxhinierë e elektroteknikes*

–

**Operatori i Sistemit, Transmisionit  
dhe Tregut të energjisë elektrike  
të Kosovës – KOSTT**

“

Në vitin 1985 inxhinieria ka qenë profesion deficitar dhe Kosova ka pas një zhvillim të madh energjetik, prandaj unë dhe studentët tjerë jemi punësuar menjëherë. Përvoja ime në këtë profesion më shtyn të inkurajoj të gjitha vajzat e reja të studiojnë elektrotekniken për shkak se iu jep kënaqësi, iu mundëson një të ardhme më të mirë, dhe do të kenë diapazon më të madh të dijes.

Sa i përket teknologjisë dhe sigurisë në punë, sot proceset janë të automatizuara dhe siguria në punë është shumë e lartë.

Sa i përket jetës private, kam pas fatin që edhe burrin ta kem inxhinier dhe gjithmonë problemet i kemi ndarë. Të gjitha arrihen, vetëm duhet të kesh vullnet dhe duhet të dominojë përkushtimi, si në familje ashtu edhe në profesion. Suksesi nuk do të mungojë. ”

## PROFILET

# Edita Bytyqi Muqkurta

*Inxhinier e elektroenergjetikës*

–

**Operatori i Sistemit, Transmisionit  
dhe Tregut të energjisë elektrike  
të Kosovës – KOSTT**



Vendimin për të studiuar energjetikën e kam marr qysh në shkollën fillore. Mirëpo, ka qenë familja ime që më ka dhënë shtysën vendimtare për t'u bërë inxhinierë. Babai, si i punësuar në Fakultetin e Inxhinierisë, na ka përkrahur që tre nga katër motrat të bëhemi inxhinierë. Në ditët e sotme kjo më bën të ndihem shumë e përmbushur. Do thoja që është fusha me më së shumti perspektivë në Kosovë, dhe kjo nuk vlen vetëm për energjinë fosile, por edhe për trendet e reja që aplikohen në sektorin e energjisë së ripërtëritshme. Për shembull, të gjitha koleget me të cilat kam studiuar sot janë të punësuar. Besoj se shtysë më të madhe se kjo nuk ka për t'u orientuar në karrierë. Nëse do kthehesha në kohë, përsëri do e zgjidhja të njejtin drejtim. Uroj që rinia e sidomos vajzat të zgjedhin sektorin e energjisë. ”





## PROFILET

# Saranda Bytyqi

*Elektroinxhinierë*

*Menaxhere e fabrikës*

–

**Jaha Solar**



Jam pjesë e kompanisë që nga themelimi duke filluar nga montimi i makinerive e deri sot kur e menaxhoj të gjithë procesin e prodhimit. Në linjën e prodhimit i kemi të paktën shtatë stacione kontrolluese për cilësinë e produktit (paneleve). Përzgjedhjen e punëtorëve e bëjmë në bashkëpunim me secilin prej tyre, dhe u japim operatorëve (punëtorëve) mundësinë të hulumtojnë secilin stacion në linjën e prodhimit. Në momentin që një vajzë apo djalë shpreh gatishmëri për një punë, si dhe ka aftësi ta kryejë atë lloj detyre, atëherë përcaktohet për atë pozitë.


Mendoj se në përgjithësi vajzat duhet të kenë guximin me provu gjëra të reja. Nuk ka punë pa sfida. Një punë mund të fillojë në makineri por mund të përfundoj me një pozitë tjetër mjaft të mirë. ”

# Gratë për rritjen e vetëdijes për energji

AWESK-u ka filluar të jetësoj objektivat strategjike përmes aktiviteteve që zbatohen nga anëtarët. Konkretisht, për të zbatuar Objektivin e dytë, shoqata ka ndërmarrë një fushatë për rritjen e vetëdijes mbi eficientësinë e energjisë dhe promovimin e konceptit të prosumatores, si dy masa të cilat gjithashtu kontribuojnë në mbrojtjen e mjedisit. Kjo fushatë ndikon direkt në rritjen e cilësisë së jetës dhe mirëqenien për vajzat dhe gratë, si dhe për mbarë shoqërinë.

## PROdhuese KonSUMATORE

Prodho energjinë tënde dhe zvogëlo konsumin nga rrjeti.  
Kursen para dhe e mbron ambientin.



### SKEMA E NJË PROSUMATORE

- ▶ PRODHON ENERGI ELEKTRIKE PËR NEVOJA SHTËPIAKE APO BIZNESI
- ▶ PRODHIMIN E TEPËRT E SHKARKON NË RRJET
- ▶ FURNIZOHET NGA RRJETI KUR MUNGON VETËPRODHIMI

[www.awesk.org](http://www.awesk.org)

*Kushtet dhe procedurat e aplikimit përcaktohen nga Zyra e Rregulatorit për Energji.  
Drejtohuni tek shoqata jonë për asistencë në proces dhe aplikim për t'u bërë prosumatore.*

**ENERGJIA NË SHTËPINË TONË**

Powerful



# AWESK

SHOQATA E GRAVE NË SEKTORIN E ENERGJISË NË KOSOVË  
ASSOCIATION OF WOMEN IN THE ENERGY SECTOR OF KOSOVO

# KURSE rrymë dhe PARA

Zbato masat për eficiencë të energjisë dhe zvogëlo konsumin.  
Kursen para dhe e mbron ambientin.



**35%**  
më pak energji

## IZOLIMI I DUHUR

Dyert, Dritaret, Muret, Çatia, Dyshemeja

[www.awesk.org](http://www.awesk.org)

Zvogëlo konsumin e energjisë elektrike dhe përdorimin e ujit, vepra zgjuar kur dhe si e përdor energjinë, parandalo humbjet, dhe zgjedh pajisje që kursejnë energji.

## ENERGJIA NË SHTËPINË TONË

**40%**  
më pak energji

## PAJISJET SHTËPIAKE EFIÇIENTE

<b>Bojleri</b>	uji në 50 gradë Celsius
<b>Lavatriçja</b>	aktivizo gjatë tarifës së ulët
<b>Enëlarësja</b>	aktivizo gjatë tarifës së ulët
<b>Pajisjet e gatimit</b>	me konsum eficient
<b>Frigoriferi</b>	me konsum eficient
<b>Kondicioneri</b>	fikeni kur nuk përdoret
<b>TV / Kompjuteri</b>	fikini kur nuk përdoren
<b>Termostati</b>	rregullator i temperaturës

**60%**  
më pak energji

## NDRIÇIM EFIÇIENT

**Poçat LED** me konsum eficient

Shpenzojnë deri në 6 herë më pak, dhe qëndrojnë deri në 10 herë më shumë

# Powerful

AWESKosovo

AWESK Kosovo

AWESKosovo

AWESK info

info@awesk.org

www.awesk.org

Përkrahur nga:



**USAID**  
NGA POPULLI AMERIKAN  
OD AMERIČKOG NARODA

# Trajnime për avancim në karrrierë

Shoqata përkrah gratë që hyjnë si dhe ato që janë aktive në sektorin e energjisë të zhvillohen profesionalisht. Ky është një orientim strategjik i shoqatës. Gjatë vitit 2020, anëtarët e AWESK-ut kanë ndjekur një cikël prej 13 trajnimeve në kuadër të projektit të financuar nga USAID-i "Sigurimi i Furnizimit me Energji në Kosovë (KESS)" dhe që është zbatuar nga kompania DT Global.

Ky program trajnues ka aftësuar pjesëmarrëset në fusha të menaxhimit dhe qëndrueshmërisë financiare të shoqatës, në fusha specifike të energjisë, si dhe në çështjet e barazisë gjinore në sektorin e energjisë.

Gjithashtu, me këto aftësi, anëtarët do të jenë në gjendje të përdorin njohuritë e tyre për të kontribuar në rritjen e angazhimit të grave dhe vajzave në sektorin e energjisë në Kosovë. Trajnimet janë zbatuar nga ekspertë të projektit KESS si dhe nga Qendra e Trajnimeve dhe Burimeve për Avokim (ATRC).







## Powerful

Ne jemi një shoqatë aktive që vazhdimisht zhvillojmë dhe zbatojmë projekte, pjesë e së cilave mund të bëheni edhe ju duke kontribuar në ide apo edhe duke përfituar prej tyre.

Ju ftojmë të na mbështesni që të përmbushim misionin tonë.



### Mirvete Gërguri

Kryesuese e Kuvendit

Përfaqësuese e Korporatës Energjetike të Kosovës (KEK) ku menaxhon zbatimin e kontratave në Zyrën e Prokurimit.

Ajo mban tituj akademik në elektroteknikë, ashtu edhe në prokurimin publik dhe menaxhim.



### Fahrije Qorraj Kaloshi

Zyrtare për anëtarësim

Është përfaqësuese nga Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit. Ajo drejton politikat për Barazinë Gjinore dhe Mundësitë e Barabarta.

## Anëtarësohu

AWESK-u është një shoqatë në rritje me anëtare të përkushtuara për integrimin e grave në sektorin e energjisë të Kosovës. Ju ftojmë të na bashkoheni në misionin tonë.

Anëtarësohu dhe përfito nga mbështetja që shoqata u ofron grave që të inkuadrohen ose zhvillohen profesionalisht në sektorin e energjisë.



## Ardiana Haxhidauti Bokshi

Arkëtare

Është ekonomiste dhe që nga viti 2006 punon si Udhëheqëse e Njesisë së Administratës në Zyrën e Rregullatorit të Energjisë. Ajo ka ndjekur shumë trajnime lidhur me menaxhimin dhe promovimin e barazisë gjinore dhe gjithëpërfshirjes sociale në sektorin e energjisë. Ajo mendon se përfshirja e grave/vajzave në energji nuk është vetëm çështje gjinore apo drejtësie por strategji e domosdoshme për zhvillimin ekonomik të vendit. Duke i përjashtuar ato nga kjo fushë talenti i një pjese të shoqërisë do të mbetet i pashfrytëzuar.

## Dhuroni

Shoqata jonë ka krijuar disa mënyra për bashkëpunim. Edhe ju mund të bëheni pjesë e projekteve tona përmes mbështetjes financiare apo donacionit.

Kontributi juaj i mundëson AWESK-ut të arrijë misionin e vet.



## Vullnetaret

Bëhuni vullnetare dhe bashkohuni komunitetit tonë të madh. Na ndihmoni të arrijmë qëllimet tona duke na përkrahur në mënyrën tuaj. Ju duam afër.

Bashkohu

[www.awesk.org](http://www.awesk.org)

 AWESKosovo

 AWESK Kosovo

 AWESKosovo

 AWESK info

 [info@awesk.org](mailto:info@awesk.org)

 [www.awesk.org](http://www.awesk.org)

Përkrahur nga:

